  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....	.....
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve .....	.....
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....	.....
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial .....	.....
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	.....
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit .....	.....
Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....	.....
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit .....	.....
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....	.....
<a href="#">Shtojca 10.</a> Formulari i Njoftimit të Fituesit.....	.....
<a href="#">Shtojca 11.</a> Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)	
<a href="#">Shtojca 12.</a> Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër	
<a href="#">Shtojca 13.</a> Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)	

---

**Shtojca1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]**në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontrates;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallratduhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimevepër artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njësi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	<b>Afati</b>
1	Dosje kartoni me llastik	300			31.12.2024
2	Dosje Arkive me Lidhese, 12 cm	200			31.12.2024
3	Dosje me mekanizëm, 7cm	150			31.12.2024
4	Bllok i verdhe	200			31.12.2024
5	Kapse aktesh nr. 3	100			31.12.2024
6	Kapse aktesh nr. 5	50			31.12.2024
7	Letër fotokopje, 80gr/m2 A4	500			31.12.2024
8	Zarfa te vegjel 11 x 23 cm	800			31.12.2024
9	Zarfa te mesem 19 x 26 cm	800			31.12.2024
10	Zarfa 23 x 33 cm (A4)	250			31.12.2024



11	Zarfa format 44x36 cm	200			31.12.2024
12	Makina llogaritese 16 digits	5			31.12.2024
13	Stilolapsa blu	200			31.12.2024
14	Blllok flete- hyrje	50			31.12.2024
15	Blllok flete- dalje	50			31.12.2024
16	Blllok urdher dorezimi	200			31.12.2024
17	Bojë vule blu	10			31.12.2024
18	USB 3.0, 32 GB	5			31.12.2024
19	Regjister themeltar	5			31.12.2024
20	Liber Protokolli 100 flete	60			31.12.2024
21	Liber Protokolli 200 flete	10			31.12.2024
22	Shufra silikoni të trasha	500			31.12.2024
23	Kartona te medhenj me ngjyra (7 ngjyra te ylberit) 1m	100			31.12.2024
24	Furca te holla	50			31.12.2024
25	Leter kalk A3	2			31.12.2024
26	Mbajtese kancelarie për mjete	20			31.12.2024
27	Fletore për aktivitetin ditor të Psikologut dhe Punonjësit Social	95			31.12.2024
28	Libër Akt-Monitorime	20			31.12.2024
29	Dosje personale e fëmijës	12000			31.12.2024
30	Bexho PVC me clip metalik	120			31.12.2024
31	Makina grirëse me kosh, dokumentesh të mëdha.	1			31.12.2024
32	Pineska me kokë të lartë me ngjyra	30			
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

#### Argumentim:

*Për hartimin e specifikimeve teknike komisioni ju është referuar kërkesave të institucionit për llojin, tipin, përmasat dhe të dhënat teknike specifike të secilit artikull që kërkohet, si dhe katalogut të miratuar nga "Operatori i Blerjeve të Përqëndruara" të publikuar në faqen zyrtare të APP.*

*Karakteristikat dhe përmasat e artikujve janë vendosur në përshtatje me natyrën dhe nevojat specifike të pozicioneve të punës për secilin nga sektorët e DPCK në funksion të kryerjes së detyrave funksionale të tyre.*

Nr.	Emërtimi i artikullit	Specifikime teknike
1	Dosje kartoni me llastik	Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, të ketë nga brenda veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave). Të mbyllet me llastik. Përmasat 24 x 34cm (marzh gabimi deri në 5%).
2	Dosje Arkive me Lidhese, 12 cm	Dosje kartoni me lidhëse, me mbeshtjellese anësore shtesë nga të tria anët. Përmasat Gjer.22 cm, Gjat. 33cm, Trash. 12 cm, (marzh gabimi deri në 5%).
3	Dosje me mekanizëm, 7cm	Dosje me mekanizëm A4, me kuti, përmasa 28 x 35 x 7 cm (deri në 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.

4	Bllok i verdhe	Permasat 76x76x100 flete
5	Kapse aktesh nr. 3	Për kapje letrash, nr.3, kutia me nga 100 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
6	Kapse aktesh nr. 5	Për kapje letrash, nr.5, kutia me nga 100 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
7	Letër fotokopje, 80gr/m2 A4	Përmasa A4 (297mm x 210mm); Lëmueshmëria 100-150ml/min sipas ISO 8791; Lagështia 3-4% sipas ISO 287; Trashësia 109-115 µm sipas ISO 534; Dukshmëria (Opacity) >94% sipas ISO 2471; Shkëlqimi 106-115% sipas ISO 247; D20-CIE Bardhësia 158-175 sipas ISO 11475.
8	Zarfa te vegjel 11 x 23 cm	Të jenë material letre, me përmasat 11 x 23 cm (deri në 5% marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.
9	Zarfa te mesem 19 x 26 cm	Të jenë material prej letre, me përmasat 19 x 26 cm (deri ne 5% marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.
10	Zarfa 23 x 33 cm (A4)	Të jenë material prej letre. Përmasat 23 x 33 cm (deri ne 5% marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.
11	Zarfa format 44x36 cm	Të jenë material letre, përmasat 44 x 36 cm (deri ne 5% marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.
12	Makina llogaritese 16 digits	Makinë 16 digit, me memorie, me të gjitha opsionet e llogaritjes, dritare lehtësisht e lexueshme. Me përmasa 190 x 150 x 40 mm (deri në 5% marzh gabimi).
13	Stilolapsa blu	Stilolapsa cilesore për shkrim të përgjithshëm. Trashësia e majës 0.7 mm- 0.9 mm (me kapak, jo me sustë)
14	Bllok flete- hyrje	Vetekopjuese 3 kopje. Me perforim, për grisjen sa me te lehte te fletëve (numri i fleteve 33x3=99)
15	Bllok flete- dalje	Vetekopjuese 3 kopje. Me perforim, për grisjen sa me te lehte te fletëve (numri i fleteve 33x3=99)
16	Bllok urdher dorezimi	Vetekopjues 2 kopje. Numri i fleteve 50x2=100. Permasat 14cm x 10cm, me kapake kartoni
17	Bojë vule blu	Bojë për vulë ngjyrë blu, e përshtatshme për të gjitha llojet e vulave. Bojë ekologjikisht e pastër dhe rezistente. Boja vjen në paketim 30ml. Kutë plastike.
18	USB 3.0, 32 GB	USB me kapacitet 32GB, porta USB 3.0, sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të të dhënave.
19	Regjister themeltar	Regjister themeltar i punonjesve. Modeli Standard. 100 flete, me kopertinë kartoni të trashë 600 gr/m2. Permasat 35 x 24 cm

20	Liber Protokolli 100 flete	Libër protokolli me 100 flete, me kopertinë kartoni të trashë 600 gr/m2. Permasat 24 x 34 cm
21	Liber Protokolli 200 flete	Libër protokolli me 200 flete, me kopertinë kartoni të trashë 600 gr/m2. Permasat 24 x 34 cm
22	Shufra silikon të trasha	Shufra silikon 11 mm - 30 cm (që përdoren ne pershtatje me pistoleten e silikonit)
23	Kartona te medhenj me ngjyra (7 ngjyra te ylberit) 1m	Tabak kartoni me përmasat 70x100 cm. Pesha specifike e kartonit 220 gr. Ngjyrat e kartonave të jenë në përpjestim të drejte në raport me sasisë totale të kërkuar, 15 tabakë për secilën ngjyrë
24	Furca te holla	Furca të holla (nga 5 cope per cdo numer nga 12/18/20/ 24)
25	Leter kalk A3	Letër kalk A3-297x420mm / gramatura 90 gsm (250 flete pako)
26	Mbajtese kancelarie për mjete	Mbajtese kancelarie për mjete, pershtatshem per te mbajtur stilolapsa, kapse teli, letra shenimesh etj. Të ketë minimumi 10 poste mbajtëse. Permasat Gjatesi 20-25 cm, Gjeresi 10-15 cm. Materiali druri ose plastik, ose lekure.
27	Fletore për aktivitetin ditor të Psikologut dhe Punonjësit Social	100 fletë (200 faqe). Të jetë i realizuar me “Lidhje libri” me ngjitje ose me lidhje (me pe) dhe jo me papercod. Kapaku i librit duhet të jetë karton 350-400 gr/m2, me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit. Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë. Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues. Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit. Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë). Përmasat: Formati A4.
28	Libër Akt-Monitorime	100 fletë (200 faqe). Të jetë i realizuar me “Lidhje libri” me ngjitje ose me lidhje (me pe) dhe jo me papercod. Kapaku i librit duhet të jetë karton 350-400 gr/m2, me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit. Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë. Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues.
29	Dosje personale e fëmijës	6 fletë (12 faqe). Të jetë i realizuar me lidhje (me pe). Kapaku i librit duhet të jetë karton me llustër 350-400 gr/m2, me ngjyrë të bardhë, me logon dhe emërtimin e institucionit. Faqet e brendshme me ngjyrë të bardhë. Modeli i saktë i logos, emërtimi i institucionit dhe shkrimet e tjera do të tërhiqen nga OE fitues. Në pjesën e brendshme të kapakut do të shkruhet modeli i dokumentit sipas përcaktimit të institucionit. Modeli i kopertinës do të jetë me 4 ngjyra, kurse faqet e brendshme me një ngjyrë (e zezë). Përmasat: Formati A4.

---

30	Bexho PVC me clip metalik	Bexho PVC me clip metalik
31	Makina grirëse me kosh, dokumentesh të mëdha.	Makinë grirëse me kosh dokumentesh të mëdha. Me kapacitet minimumi 10 fletë njëherësh, Të grijë CD, kartë krediti, kapëse, tela.
32	Pineska me kokë të lartë me ngjyra	Me maja me ngjyra, koka e mbuluar material plastik, kutia minimumi me 50 copë.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Llojet dhe sasia e mallit që do të lëvrohet është si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Sasia	Afati I levrimit
1	Dosje kartoni me llastik	Copë	300	Lëvrimiti mallit do të kryhet në dy kohë. Afati I levrimit 20 ditë nga kërkesa e AK
2	Dosje Arkive me Lidhese, 12 cm	Copë	200	
3	Dosje me mekanizëm, 7cm	Copë	150	
4	Blllok i verdhe	Copë	200	
5	Kapse aktesh nr. 3	Kuti	100	
6	Kapse aktesh nr. 5	Kuti	50	
7	Letër fotokopje, 80gr/m2 A4	Risma 500 fletë	500	
8	Zarfa te vegjel 11 x 23 cm	Copë	800	
9	Zarfa te mesem 19 x 26 cm	Copë	800	
10	Zarfa 23 x 33 cm (A4)	Copë	250	
11	Zarfa format 44x36 cm	Copë	200	
12	Makina llogaritese 16 digits	Copë	5	
13	Stilolapsa blu	Copë	200	
14	Blllok flete- hyrje	Copë	50	
15	Blllok flete- dalje	Copë	50	
16	Blllok urdher dorezimi	Copë	200	
17	Bojë vule blu	Shishe	10	
18	USB 3.0, 32 GB	Copë	5	
19	Regjister themeltar	Copë	5	
20	Liber Protokolli 100 flete	Copë	60	
21	Liber Protokolli 200 flete	Copë	10	
22	Shufra silikoni të trasha	Shufra	500	
23	Kartona te medhenj me ngjyra (7 ngjyra te ylberit) 1m	Copë	100	
24	Furca te holla	Copë	50	
25	Leter kalk A3	Pako	2	
26	Mbajttese kancelarie për mjete	Cope	20	



27	Fletore për aktivitetin ditor të Psikologut dhe Punonjësit Social	Copë	95	
28	Libër Akt-Monitorime	Copë	20	
29	Dosje personale e fëmijës	Copë	12000	
30	Bexho PVC me clip metalik	Copë	120	
31	Makina grirëse me kosh, dokumentesh të mëdha.	Copë	1	
32	Pineska me kokë të lartë me ngjyra	Kuti	30	

### **Afati i levrimit te mallit.**

Malli do të lëvrohet me kërkesën e AK, në përshtatje me afatet e përcaktuar më sipër në mënyrë specifike sipas artikujve.

Për arsye se volumi që zënë një pjesë e materialeve kancelerik është i konsiderueshëm, për arsye magazinimi, AK parashikon që levrimiti i mallit për këta artikuj do të kryhet në dy kohë. Afati i levrimitit 20 ditë nga kërkesa e AK

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

---

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

##### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të paraqitura për vitet financiare 2022, 2023 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2022, 2023, ku vlera e xhiron për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

##### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një entitet publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasinat dhe llojet e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasinat dhe llojet e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente, të vlefshme, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila përfshin objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon 1 (një) automjet qe do te sherbeje per transportin e produkteve objekt prokurimi, ne pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 1 (një) automjet, ne pronësi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik

Në rastin kur automjeti është me qera/në përdorim, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

2.3.4 Ditën e hapjes së tenderit, Operatorët ekonomikë konkures duhet te paraqesin një mostër sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor per artikujt e mëposhtëm:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Sasia
1	Dosje me llastik	Copë	1
2	Dosje Arkive me Lidhese	Copë	1
3	Dosje me mekanizem	Copë	1
4	Leter A4	Pako	1
5	Mbajtese kancelarie për mjete	Copë	1
6	Makina llogaritese	Copë	1
7	Stilolapsa blu	Copë	1
8	Bllok flete- hyrje	Copë	1
9	Bllok flete- dalje	Copë	1

Mostrat do paraqitet ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, prane D.P.Ç.K me adrese “Rr. E Barrikadave, Çerdhja nr. 1 Tirane”.

Mostrat e kërkuua duhet të kenë një etiketë me vulë e cila të përmbaje përshkrimin:

- *Moster “emri i artikullit”,*
- *Daten e zhvillimit te tenderit,*
- *Emrin e ofertuesit,*
- *Nënshkrimin dhe Vulen e operatorit ekonomik*

**Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.**

---

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar, ose paraqitja e dokumentave të rreme, përbën kusht për skualifikim.**

***Argumentim për hartimin e kriterëve teknike të kualifikimit:***

- *Kriteri që OE duhet të jetë i paisur me çetifikatë ISO 9001:2015 konsisiton në kërkesën që OE konkurues duhet të zotërojë “Sistemin i menaxhimit të cilësisë” së produkteve që ai tregëton.*
- *Kriteri që OE ku të deklarojë se disponon 1 (një) automjet që do të shërbejë për transportin e produkteve objekt prokurimi, është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës për procesin e lëvrimin të mallit në magazinën e AK, sipas grafikut të lëvrimin.*
- *AK ka kërkuar që ditën e hapjes së tenderit, OE konkurues duhet te paraqesin një mostër sipas specifikimeve teknike, për disa nga artikujt e listës objekt prokurimi. Artikujt për të cilët kërkohet mostër janë përzgjedhur në raport me karakteristikat specifike që ato kanë si dhe në raport me sasinë dhe vlerën që ato zënë në listën e përgjithshme të artikjve objekt prokurimi.*

**Argumentim mbi hartimin e Fondit Limit:**

Për përcaktimin e fondit limit, Komisioni është bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Për përcaktimin e fondit limit i është referuar Informacionit për llogaritjen e sasisë së planifikuar për blerje kancelari për vitin 2024.
- Çmimi është përcaktuar nga mesatarja e çmimeve që del bazuar në Proces - Verbalin e Testimit të Tregut.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"><li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul>
---

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>



---

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë (**Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID**) :

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

□

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
  - a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:
- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

